

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË TRYEZËN RAJONALE
“ROLI I INSTITUCIONEVE TË BARAZISË DHE I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË
SISTEMIN GJYQËSOR”**

9 dhjetor 2021

E nderuar Avokate e Popullit, i nderuar Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të nderuar pjesëmarrës!

Së pari, përshëndes organizimin e kësaj tryeze rajonale për Institucionet e të Drejtave të Njeriut dhe jam i kënaqur që shoh që janë përfaqësuar institucionet përkatëse nga rajoni. Jemi mbledhur këtu për të diskutuar për të Drejtat e Njeriut, tematikë që përbën thelbin e punës së OSBE-së. Në fakt, OSBE-ja ofron, në parim, një hapësirë të madhe gjeografike për lulëzimin e të drejtave të njeriut, pasi kufijtë e OSBE-së, shtrihen në tri kontinente, nga Vankuveri në Vladivostok, nga Paqësori në Paqësor. Dhe nuk dua të bëhem i rëndomtë duke vënë në pah këtu rëndësinë e jashtëzakonshme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ajo që është më pak e rëndomtë dhe, ndoshta, duhet ripohuar në çdo rast, është natyra universale e të drejtave të njeriut. Ato vlejné për të gjithë dhe kudo.

Megjithatë, shohim, jo në Shqipëri, përpjekje për t'i riinterpretuar ato sipas vlerave vendore, për t'i rajonalizuar. Është e vështirë të besohet se ka individë që janë gati të heqin dorë nga të drejtat tyre për liri dhe siguri. Si mund të thuhet se **jo** të gjithë duam të jetojnë pa u diskriminuar, skllavëruar, apo torturuar?

Nesër është Dita e të Drejtave të Njeriut dhe e miratimit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

Të gjithë jemi përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por rolin parësor e ka shteti. Prandaj, Institucionet e Pavarura të të Drejtave të Njeriut janë sinapse të domosdoshme për të garantuar zbatimin efektiv të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në nivel kombëtar, për të qenë një urë lidhëse midis qytetarëve dhe shtetit, për të mbrojtur njerëzit në nevojë dhe për të kërkuar që qeveritë të përmbushin detyrimet ndaj të drejtave të njeriut. Me pak fjalë, institucionet e të drejtave të njeriut ripohojné universalitetin e të Drejtave të Njeriut dhe i fuqizojné ato më shumë me punën e tyre të përditshme. Dëshiroj të përgëzoj znj. Erinda Ballanca dhe zyrën e saj, Komisionerin Gajda dhe zyrën e tij, si edhe të gjitha Institucionet e pavarura shqiptare të të drejtave të njeriut për punën e tyre të jashtëzakonshme. Siç e dini, në Kopenhagë, në vitin 1990, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u zotuan të “... lehtësojnë krijimin dhe forcimin e institucioneve të pavarura kombëtare në fushën e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit...”

Puna e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri drejtohet nga angazhimet e OSBE-së, por informohet nga realiteti konkret në vend. Në këtë kuptim, pjesëmarrja juaj në këtë tryezë të rrumbullakët rajonale na mundëson të kuptojmë më mirë se si mund të kontribuojmë në forcimin e bashkëpunimit rajonal. Dhe të forcojmë bashkëpunimin tonë me vendin pritës, Shqipërinë.

Prezenca i ka mbështetur institucionet e të drejtave të njeriut që nga themelimi i tyre dhe, së fundmi, ka luajtur një rol të rëndësishëm në lehtësimin e nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet tyre. Ajo ka mbështetur Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në organizimin e konferencës së tretë të strukturave për barazinë në Tiranë si dhe për të ngritur kapacitetet e stafit të institucionit në fushën e mbledhjes dhe monitorimit të të dhënave të bazuara në të drejtat e njeriut. Prezenca, po ashtu ka dhënë komente dhe opinione ligjore për hartimin e legjislacionin të ri apo përmirësimin e atij ekzistues për të drejtat e njeriut.

Të nderuar pjesëmarrës,

Nëse e afrojmë lupën te fokusi i tryezës së sotme mbi rolin e institucioneve të të drejtave të njeriut në sistemin gjyqësor, mund të shohim qartë rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit rajonal mes jush. Në fakt, qëllimi i kësaj tryeze nuk është vetëm shkëmbimi i praktikave më të mira dhe diskutimi i ndërsjellë, por ajo shërben, gjithashtu, siç kërkohet nga Parimet e Parisit, për forcimin e rrjetit rajonal të bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve. Për më tepër, ky takim mund të shërbejë si shtysë për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me detyrimet e qeverive përkatëse në drejtim të mbrojtjes nga diskriminimi dhe promovimit të punës së institucioneve të të drejtave të njeriut.

Ju uroj diskutime të frytshme!